



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 63 prot.

Kamëz, më 25.8.2025

V E N D I M

Nr. 54 .Datë 25 / 8 2025

MBI

**“MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT TË BARAZISË GJINORE 2025-2030”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 25.08.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.50 Datë 19.08.2025 Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ligji 47/2018 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënie familjare”, ligji 22/2018 “Për Strehimin Social” ligji 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, ligji “Për Barazinë Gjinore” si dhe Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 150 datë 20.03.2019 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”, **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e “Planit të Veprimit të Barazisë Gjinore 2025-2030”.
2. Ngarkohet për zbatim Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë**.

KRYETAR KËSHILLI  
HYSEN KOLDASHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAMËZ  
DREJTORIA E NDIHMËS EKONOMIKE DH ÇËSHTJEVE SOCIALE

Nr. 50 prot.

Kamëz, më 19 . 08 . 2025

**PROJEKT - VENDIM**

Nr 50 Datë 19 / 8 / 2025

**PËR**

**MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT TË BARAZISË GJINORE 2025-2030**

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ligji 47/2018 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënie familjare”, ligji 22/2018 “Për Strehimin Social” ligji 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, ligji “Për Barazinë Gjinore” si dhe Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 150 datë 20.03.2019 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”.

**PROPOZJMË:**

1. Miratimin e “Planit të Veprimit të Barazisë Gjinore 2025-2030”
2. Ngarkohet për zbatim Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale
3. Ky Projekt-Vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 39/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 55, pika 6 dhe konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

**Drejtore i Ndihmës Ekonomike  
dhe Çështjeve Sociale**

**Marime Vladi**

**Drejtore i Çështjeve Ligjore  
dhe Prokurimeve Publike**

**Eni Bistri**

**Drejtore Finance**

**Vjollca Smaçi**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAMËZ  
DREJTORIA E NDIHMËS EKONOMIKE DH ÇËSHTJEVE SOCIALE

**Znj. Rivjana Hoxha**

Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore

**Znj. Peme Marku**

Drejtor i Drejtorisë së Integritetit në Be dhe Zhvillimit Ekonomik

**Znj. Eralda Allushi**

Përgjegjëse e Sektorit për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Barazinë Gjinore

**Znj. Erina Halili**

Përgjegjëse e sektorit për Personat me Aftësi të Kufizuar

**Znj. Mariela Koka**

Specialiste pranë Drejtorisë së Medias

**Znj. Alba Preni**

Specialiste pranë Drejtorisë së Financës dhe Kontabilitetit

**Znj. Valdete Hoxha**

Specialiste pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore

**Znj. Feride Noka**

Përgjegjëse e Sektorit të Psikologeve pranë Drejtorisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit

**Znj. Esmeralda Dalti**

Specialiste pranë Ujësjetës Kanalizime Kamëz

**Z. Sajmir Kurti**

Anëtar i Këshillit Bashkiak, Komisioni I Barazisë Gjinore

**Znj. Edlira Lama**

Specialiste e Barazisë Gjinore pranë Lagjes Administrative Nr. 1

**Znj. Lela Simoni**

Specialiste e Barazisë Gjinore pranë Njesisë Administrative Paskuqan



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAMËZ  
DREJTORIA E NDIHMËS EKONOMIKE DH ÇËSHTJEVE SOCIALE

**Znj. Elona Tërshalla**

Specialiste pranë Drejtorisë së Strehimit Social

**Znj. Esmeralda Troci**

Specialiste e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore

**KRYETARI**

**Rakip SULI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAMËZ

DREJTORIA E NDIHMËS EKONOMIKE DH ÇËSHTJEVE SOCIALE

DIPE

STARI  
KAMËZ

Nr. \_\_\_\_ prot.

Kamëz, më \_\_\_\_ . 08 . 2025

RELACION

MBI

MIRATIMIN E PLANIT BARAZISË GJINORE 2025-2030

Të nderuar!

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ligji 47/2018 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënie familjare”, ligji 22/2018 “Për Strehimin Social” ligji 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, ligji “Për Barazinë Gjinore” si dhe Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 150 datë 20.03.2019 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”, në cilësinë e strukture përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror në Bashkinë Kamëz, i propozojmë Këshillit Bashkiak:

**1. Miratimin e “Planit të Veprimit të Barazisë Gjinore 2025-2030”**

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2025 - 2030 u përgatit nga Bashkia Kamëz, si mjeti kryesor për zbatimin e angazhimeve publike për barazinë gjinore, të ndërmarra nëpërmjet nënshkrimit të Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore.

*Vizioni: “Gratë dhe burrat, të rejtat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë e Kamzës, pavarësisht moshës, vendbanimit, grupit etnik e social, aftësive të kufizuara e nevojave të veçanta, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, statusit civil, të emigrantes/emigrantit e azilkërkueses/azilkërkuesit, statusit të punësimit e gjendjes ekonomike, përkatësisë fetare, apo karakteristikave të tjera*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA KAMËZ**  
**DREJTORIA E NDIHMËS EKONOMIKE DH ÇËSHTJEVE SOCIALE**

*individuale, gëzojnë, respektojnë dhe kontribuojnë për përparimin drejt barazisë gjinore dhe zbatimin e saj në praktikë, në të gjitha fushat e jetës”.*

Aktualisht, në respektim edhe të detyrimeve të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore, Bashkia Kamëz ndërmorri hapat për të përgatitur dhe miratuar Planin Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore, në përputhje me të gjitha standartet kombëtare e ndërkombëtare, si dhe në respektim të plotësimit të kërkesave për integrimin në Bashkimin Evropian.

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2025 – 2030, u hartua përmes një procesi ndërveprues dhe gjithëpërfshirës, në bashkëpunim dhe konsultim me të gjitha drejtoritë e bashkisë, njësitë administrative, institucionet publike vendore, organizatat e shoqërisë civile, Aleancën e Grave Këshilltare dhe anëtare e anëtarë të Këshillit Bashkiak. I gjithë procesi u mbështet nga UN Women Shqipëri në kuadër të Projektit & “Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore II - Instrumenti i Lehtësimit të Barazisë Gjinore në Shqipëri” (EU4GE II), që financohet nga Bashkimi Evropian.

PVVBGJ 2025 - 2030 përbëhet nga katër fusha kryesore të ndërhyrjes, të cilat jo vetëm kanë në përmbajtje nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi, por janë harmonizuar edhe me një pjesë të objektivave specifike të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030, sidomos ato që përmbajnë masa dhe veprime ku përgjegjës kryesorë për zbatim janë

Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV). Këto fusha ndërhyrjeje janë:

I. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre.

II. Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave dhe të rejave e të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike apo publike në nivelin vendor.

III. Liri nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje.

IV. Integrimi gjinor në politikat vendore.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA KAMËZ**  
**DREJTORIA E NDIHMËS EKONOMIKE DH ÇËSHTJEVE SOCIALE**

Secila nga këto fusha të ndërhyrjes është zbërthyer më tej në rezultatet e pritshme, objektivat specifike, treguesit e matjes së tyre, si dhe në masa e veprime konkrete, të cilat detajohen në matricën e planit të veprimit, ku jepet një informacion më i plotë si për zbatimin dhe vlerësimin e rezultateve, ashtu edhe për sa u përket neneve specifike të Kartës Evropiane, si dhe dokumenteve të tjerë kryesorë ku mund të referohemi, në përmbushje të veprimeve të parashikuara nën secilën fushë ndërhyrjeje.

Përparimi dhe efektiviteti në zbatimin e PVVBGJ kërkon domosdoshmërisht vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme dhe të mjaftueshme njerëzore, financiare e infrastrukturore, si dhe koordinimin e veprimeve dhe bashkëpunimin ndërinstitucional me institucionet e tjera vendore, organizatat e shoqërisë civile, bizneset, median, si dhe organizatat ndërkombëtare të cilat punojnë për fuqizimin e grave dhe arritjen e barazisë gjinore.

Mbledhja dhe përditësimi rregullisht i të dhënave të ndara jo vetëm sipas seksit, por edhe sipas një tërësie karakteristikash të tjera individuale, monitorimi i vazhdueshëm mbi ecurinë e zbatimit të veprimeve të parashikuara, si dhe transparenca e llogaridhënia për rezultatet e arritura, janë gjithashtu domosdoshmëri për të përparuar drejt vizionit që udhëheq këtë PVVBGJ.

Bashkangjitur do të gjeni:

- 1) Planin e Veprimit të Barazisë Gjinore 2025-2030

Duke shpresuar në miratimin e këtij projekt-vendimi.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

**DREJTOR**

**Marime VLADI**



# **PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2025 - 2030**

GUSHT 2025

1/1A KAMËZ



# PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2025 - 2030

**PËRGATITUR NGA BASHKIA KAMËZ  
NË KUADËR TË ZBATIMIT TË  
STRATEGJISË KOMBËTARE PËR BARAZINË GJINORE 2021 – 2030  
SI DHE  
KARTËS EVROPIANE PËR BARAZI TË GRAVE DHE BURRAVE NË JETËN  
VENDORE**

**GUSHT, 2025**

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2025 – 2030 u përgatit nga Bashkia Kamëz me mbështetjen e UN Women Shqipëri në kuadër të zbatimit të projektit: Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore II - Instrumenti i Lehtësimit të Barazisë Gjinore në Shqipëri" (EU4GE II), që financohet nga Bashkimi Evropian.



**Grupi i punës:**

1. Marime Vladi, Drejtore e Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale
2. Rivjana Hoxha, Drejtore e Burimeve Njerëzore
3. Peme Marku, Drejtore e Integrimit në BE
4. Eralda Allushi, Përgjegjëse për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Barazinë Gjinore
5. Erina Halili, Përgjegjëse për Çështjet e Personave me Aftësi të Kufizuara
6. Mariela Koka, Specialiste e Drejtorisë së Medias
7. Alba Preni, Specialiste e Financës dhe Buxhetit
8. Valdete Hoxha, Specialiste e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore
9. Feride Noka, Specialiste, Psikologe e Drejtorisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit
10. Esmeralda Dajti, Specialiste pranë Ujësjetës Kanalizime Kamëz
11. Sajmir Kurti, Anëtar i Këshillit Bashkiak, Komisioni i Barazisë Gjinore
12. Edlira Lama, Specialiste e Barazisë Gjinore, Lagjja Administrative Nr.1
13. Lela Simoni, Specialiste e Barazisë Gjinore, Njësia Administrative Paskuqan
14. Elona Tërshalla, Specialiste e Drejtorisë së Strehimit Social
15. Esmeralda Troci, Specialiste e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore

**Ekspertiza teknike nga EU4GE II:**

1. Monika Kocaqi, Konsulente për integrimin gjinor dhe vetëqeverisjen vendore
2. Diamanta Vito, Konsulente për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor dhe vetëqeverisjen vendore

© Bashkia Kamëz, 2025. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

**Sqarim:**

Ky dokument përmban mendimet dhe pikëpamjet e shprehura nga autorët dhe autorët dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e UN Women, Bashkimit Evropian, Kombeve të Bashkuara apo organizmave të saj.

## *Fjala e Kryetarit*

*Barazia gjinore nuk është vetëm një angazhim ligjor dhe moral, por edhe një faktor thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të komunitetit tonë. Bashkia Kamëz është e vendosur të ndërtojë një shoqëri më të drejtë dhe më të barabartë, ku gratë, burrat, të rejat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre, të kenë mundësi të barabarta për të kontribuar dhe përfituar nga zhvillimi ekonomik, social dhe institucional i qytetit tonë.*

*Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2025 - 2030 është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës, të udhëhequr nga Bashkia Kamëz në bashkëpunim me komunitetin, shoqërinë civile, organizatat ndërkombëtare dhe partnerët teknikë. Ky plan reflekton nevojat konkrete të qytetareve dhe qytetarëve tanë dhe ndërton ura bashkëpunimi për të përmirësuar qasjen në shërbime, për të fuqizuar gratë dhe të rejat ekonomikisht, për të rritur pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje dhe për të forcuar mekanizmat vendorë për mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore.*

*Bashkia Kamëz do të garantojë zbatimin efektiv të këtij plani përmes përfshirjes së të gjitha drejtorive dhe strukturave vendore, duke siguruar që perspektiva gjinore të integrohet në të gjitha politikat dhe buxhetet tona. Ne jemi të bindur se vetëm përmes një qasjeje të barabartë dhe gjithëpërfshirëse mund të ndërtojmë një qytet më të fortë, më të drejtë dhe më të qëndrueshëm.*

*Me këtë plan, ne jo vetëm përmbushim detyrimet tona ligjore dhe strategjike, por japim një mesazh të qartë: Bashkia Kamëz është dhe do të mbetet një partner aktiv dhe i përgjegjshëm në ndërtimin e një shoqërie të barabartë për të gjitha/gjithë qytetarët dhe qytetarët e saj.*

**Z. Rakip Suli**  
Kryetar  
Bashkia Kamëz

## TABELA E PËRMBAJTJES

|                                                                              |    |
|------------------------------------------------------------------------------|----|
| LISTA E SHKURTIMEVE DHE AKRONIMEVE .....                                     | 4  |
| I. HYRJE .....                                                               | 5  |
| II. KUADRI LIGJOR DHE INSITUCIONAL .....                                     | 9  |
| III. METODOLOGJIA.....                                                       | 12 |
| IV. VIZIONI, FUSHAT E NDËRHYRJES DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË.....               | 14 |
| V. KOSTO PËR ZBATIMIN E PVVBGJ 2025 - 2030.....                              | 17 |
| VI.RAPORTIMI DHE MONITORIMI .....                                            | 21 |
| VII. MATRICA E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2025 – 2030... | 22 |

## LISTA E SHKURTIMEVE DHE AKRONIMEVE

|            |                                                                                                                                                                                                                               |
|------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| AGK        | Aleanca e Grave Këshilltare                                                                                                                                                                                                   |
| AKPA       | Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi                                                                                                                                                                                     |
| AZHBR      | Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural                                                                                                                                                                                      |
| BE         | Bashkimi Evropian                                                                                                                                                                                                             |
| BGJ        | Barazia Gjinore                                                                                                                                                                                                               |
| CEDAW      | Konventa për Eliminimin e të Gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave                                                                                                                                                       |
| DHBGJ      | Dhuna me Bazë Gjinore                                                                                                                                                                                                         |
| DHF        | Dhuna në Familje                                                                                                                                                                                                              |
| ETN        | Ekipi Teknik Ndërdisiplinar (për rastet e dhunës në familje)                                                                                                                                                                  |
| EU GAP III | Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i Bashkimit Evropian III                                                                                                                                                                |
| GTN        | Grupi Teknik Ndërsektorial (për rastet e abuzimit të fëmijëve)                                                                                                                                                                |
| KB         | Këshilli Bashkiak                                                                                                                                                                                                             |
| KBRE       | Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve të Evropës                                                                                                                                                                                   |
| LGBTI+     | Persona lezbike, gej, biseksuale/ë, transgjinore/ë, transseksuale/ë, interseks dhe cilëndo persona të tjerë orientimi seksual dhe/ose shprehja e identitetit gjinor të të cilave/ëve është i ndryshëm nga heteroseksualet/ët. |
| MKR        | Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje                                                                                                                                                            |
| MSHMS      | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale                                                                                                                                                                                |
| NBGJ       | Nëpunëse/Nëpunës i Barazisë Gjinore                                                                                                                                                                                           |
| NJA        | Njësi Administrative                                                                                                                                                                                                          |
| NJVKSH     | Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor                                                                                                                                                                                         |
| NJVV       | Njësi e Vetëqeverisjes Vendore                                                                                                                                                                                                |
| OJF        | Organizatë Jo-Fitim-Prurëse                                                                                                                                                                                                   |
| ON         | Organizatë Ndërkombëtare                                                                                                                                                                                                      |
| OS         | Objektiv Specifik                                                                                                                                                                                                             |
| OSHC       | Organizatë e Shoqërisë Civile                                                                                                                                                                                                 |
| PVVBGJ     | Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore                                                                                                                                                                                  |
| SKBGJ      | Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (2021-2030)                                                                                                                                                                         |
| VKB        | Vendim i Këshillit Bashkiak                                                                                                                                                                                                   |
| ZVAP       | Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar                                                                                                                                                                                        |

## I. HYRJJE

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2025 - 2030 u përgatit nga Bashkia Kamëz, si mjeti kryesor për zbatimin e angazhimeve publike për barazinë gjinore, të ndërmarra nëpërmjet nënshkrimit të Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore.<sup>1</sup>

Bashkia Kamëz e ka nënshkruar këtë dokument të rëndësishëm të përgatitur nga Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve Evropiane<sup>2</sup>, në 29 maj 2020<sup>3</sup>, duke ndërmarrë kështu një angazhim publik për të bërë realitet arritjen e barazisë gjinore në Kamëz. Për shkak të situatave lidhur me menaxhimin e emergjencave (filluar që në vitin 2019 me tërmetin e në vazhdim me situatën gjatë dhe post Covid) Bashkia Kamëz nuk e shoqëroi nënshkrimin e Kartës me një Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore, por dhe nuk hoqi dorë nga zbatimi i Kartës. Gjatë kësaj periudhe, Bashkia Kamëz ndër të tjera fuqizoi strukturat e brendshme duke iu caktuar si detyra shtesë për adresimin e çështjeve të barazisë gjinore disa specialisteve në strukturën e bashkisë dhe të njësive administrative.<sup>4</sup> Gjithashtu, pozicioni i Koordinares Vendore kundër Dhunës në Familje është i ndarë nga ai i Nëpunëses së Barazisë Gjinore.

Aktualisht, në respektim edhe të detyrimeve të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore (objektivi specifik IV.3, aktiviteti IV.3.1.d.), Bashkia Kamëz ndërmorri hapat për të përgatitur dhe miratuar Planin Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore, në përputhje me të gjitha standartet kombëtare e ndërkombëtare, si dhe në respektim të plotësimit të kërkesave për integrimin në Bashkimin Evropian.

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2025 – 2030, u hartua përmes një procesi ndërveprues dhe gjithëpërfshirës, në bashkëpunim dhe konsultim me të gjitha drejtoritë e bashkisë, njësitë administrative, institucionet publike vendore, organizatat e shoqërisë civile, Aleancën e Grave Këshilltare dhe anëtare e anëtarë të Këshillit Bashkiak.

I gjithë procesi u mbështet nga UN Women Shqipëri në kuadër të Projektit "Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore II - Instrumenti i Lehtësimit të Barazisë Gjinore në Shqipëri" (EU4GE II), që financohet nga Bashkimi Evropian.

**Barazia gjinore** nënkupton që të gjitha qeniet njerëzore, si gratë dhe burrat, janë të lira/lirë të zhvillojnë aftësitë e tyre personale dhe të bëjnë zgjedhje pa pasur kufizime të vëna nga stereotipet gjinore, rolet e ngurta gjinore, apo paragjykimet. Barazi gjinore do të thotë që sjelljet, aspiratat dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave merren parasysh, vlerësohen dhe favorizohen në mënyrë të barabartë. Barazi gjinore nuk do të thotë që gratë dhe burrat duhet të bëhen të njëjtë, por që të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre nuk do të varen nga fakti nëse kanë lindur femra apo meshkuj. (UN Women, 2011).

<sup>1</sup> Shih: [https://ccre-cemr.org/wp-content/uploads/2024/03/Charter\\_2022\\_EN.pdf](https://ccre-cemr.org/wp-content/uploads/2024/03/Charter_2022_EN.pdf)

<sup>2</sup> Shih: <https://ccre-cemr.org/>

<sup>3</sup> Shih: [https://charter-equality.eu/atlas-of-signatories-of-the-charter/signataires.html?send=ok&c\\_id=1&nb\\_id=0&cf\\_id=0](https://charter-equality.eu/atlas-of-signatories-of-the-charter/signataires.html?send=ok&c_id=1&nb_id=0&cf_id=0)

<sup>4</sup> Konkretisht këto detyra janë reflektuar në pozicionet: Përgjegjëse për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Barazinë Gjinore, Specialiste për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Barazinë Gjinore, Specialiste të Barazisë Gjinore në Njësi Administrative dhe Lagje, etj.

**Drejtësia gjinore** nënkupton që gratë dhe burrat trajtohen në mënyrë të drejtë, sipas nevojave të tyre përkatëse. Kjo mund të përfshijë trajtim të barabartë, ose trajtim që është i ndryshëm, por që konsiderohet i barasvlershëm për sa i përket të drejtave, përfitimeve, detyrimeve dhe mundësive. Në kontekstin e zhvillimit, synimet për drejtësi gjinore shpesh kërkojnë përfshirjen e masave që kompensojnë për disavantazhet historike dhe sociale të grave. (UN Women, 2011).<sup>5</sup>

Sikurse përshkruhet edhe në tekstin e Kartës Evropiane për Barazi, njësitë e vetëqeverisjes vendore janë sfera të qeverisjes që gjenden më pranë njerëzve, ndaj dhe përfaqësojnë nivelet që kanë më tepër mundësi të luftojnë vazhdimësinë dhe riprodhimin e pabarazive, si dhe të përparojnë për një shoqëri me të vërtetë të barabartë. Këto mund të arrihen duke ndërthurur zbatimin e kompetencave të tyre me bashkëpunimin me të gjithë gamën e aktorëve vendorë, për veprime konkrete në favor të barazisë ndërmjet grave dhe burrave<sup>6</sup>, të rejave dhe të rinjve<sup>7</sup>, vajzave dhe djemve.<sup>8</sup> Zbatimi dhe promovimi i të drejtës së barazisë duhet të qëndrojë në zemër të konceptit të vetëqeverisjes vendore.

PVVBGJ 2025 - 2030 është konceptuar dhe lidhur logjikisht me nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi, me kuadrin ligjor dhe të politikave kombëtare, si dhe instrumentet kryesorë ndërkombëtarë të ratifikuar nga shteti shqiptar lidhur me barazinë gjinore. Fuqizimi i grave, të rejave e vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, mbetet një ndër synimet kryesore, për përmbushjen e objektivave të barazisë gjinore për Bashkinë Kamëz.

Të gjitha masat dhe veprimet e paraqitura si pjesë e PVVBGJ 2025 - 2030, janë shoqëruar me të dhëna lidhur me treguesit e rezultateve, drejtoritë kryesore përgjegjëse dhe institucionet e organizatat partnere në zbatim, afatet kohore, përgjegjësit për monitorim, si dhe kostot e nevojshme për zbatim. Këto patjetër që janë lidhur dhe me fushat e ndërhyrjes, rezultatet e pritshme, objektivat specifike, treguesit përkatës dhe dokumentet kryesorë ku mbështeten hapat e planifikuar.

Pavarësisht ndërhyrjeve dhe përmirësimeve të vazhdueshme, me gjithë përpjekjet e bëra apo që vijnë të bëhen ndër vite për përparimin drejt barazisë gjinore, si dhe plotësimin e harmonizimit të kuadrit ligjor dhe të politikave vendore me ato kombëtare e ndërkombëtare, duhet të pranojmë që realiteti ende flet për barazi dhe drejtësi gjinore të munguara në praktikë. Pabarazitë dhe diskriminimi apo disavantazhi i shumëfishtë, jo vetëm ndërmjet gjinive por edhe ndërmjet grupeve brenda të njëjtës gjini, vijnë të mbështeten në një sërë nocionesh shoqërore të ndërtuara mbi bazën e stereotipeve të shumta të pranishme në familje, arsim, kulturë, komunikim, botën e punës, në organizimin e shoqërisë, etj.

Prandaj, nëse duam të krijojmë një shoqëri të mbështetur në barazi, është thelbësore që organet e vetëqeverisjes vendore të marrin parasysh plotësisht integrimin gjinor në politikën, organizimin dhe praktikën e tyre të punës. Barazia e vërtetë ndërmjet grave dhe burrave, të

<sup>5</sup> Për një listë më të plotë me koncepte mund të vizitoni edhe: <https://eige.europa.eu/thesaurus/browse>

<sup>6</sup> "Gra dhe burra" në këtë PVVBGJ nënkupton periudhën moshore duke filluar nga mbi 29 vjeç, deri në fund të jetës (përfshirë edhe të moshuarat/moshuarit).

<sup>7</sup> "Të reja dhe të rinj" në këtë PVVBGJ nënkupton periudhën moshore nga 15 - 29 vjeç, në respektim edhe të Ligjit Nr. 75/2019 "Për Rininë", i ndryshuar.

<sup>8</sup> "Vajza dhe djem" në këtë PVVBGJ nënkupton periudhën moshore nga 0 - 18 vjeç, në përputhje me Ligjin Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" (neni 3, pika 4).

rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, është gjithashtu edhe çelësi për suksesin tonë ekonomik dhe shoqëror.

Asnjë ndërhyrje e bërë me sado kujdes dhe burime në dispozicion, nuk mund të jetë e suksesshme nëse nuk merr në konsideratë dhe nuk adreson siç duhet e në mënyrë të barabartë, nevojat e ndryshme të grave e burrave, të rejave e të rinjve, vajzave e djemve, pra të të gjitha/gjithë anëtareve dhe anëtarëve të komunitetit. Megjithatë, fuqizimi i grave, të rejave e vajzave, mbetet një ndër synimet kryesore, për përmbushjen e objektivave të barazisë gjinore.

Në këtë kontekst, Bashkia Kamëz është e përkushtuar në ndërtimin e një komuniteti gjithëpërfshirës, ku çdo qytetare dhe qytetar të ketë akses të barabartë në shërbime dhe mundësi për zhvillim social. Politikat vendore synojnë të krijojnë kushte për pjesëmarrje aktive të grupeve në nevojë, për të siguruar përfshirjen e tyre të plotë në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore të territorit të bashkisë.

Edhe pse janë ndërmarrë hapa për përmirësimin e situatës sociale dhe fuqizimin e grupeve të cënueshme, praktikrat dhe qëndrueshmëria e ndërhyrjeve për barazinë gjinore kërkojnë përforsim të mëtejshëm. Sfidat konkrete mbeten të shumta: gratë përfaqësohen në mënyrë të kufizuar në tregun formal të punës, përfshirja e tyre në sipërmarrje është e ulët, qasja në pasuri dhe prona është ende e pabarabartë, dhe shumica e barrës së përkujdesjes familjare bie mbi to. Mungesa e shërbimeve të kujdesit për fëmijët në të gjithë territorin, sidomos në zonat rurale, infrastruktura sociale jo e mjaftueshme dhe normat tradicionale gjinore përforcojnë më tej kufizimet e grave dhe të rejave në jetën publike, ekonomike dhe institucionale.

Nëpërmjet strukturave dhe shërbimeve të saj, Bashkia Kamëz synon të adresojë në mënyrë të drejtpërdrejtë nevojat e grave, burrave, të rejave, të rinjve, vajzave e djemve apo edhe të të moshuarave dhe të moshuarve, duke promovuar politika të ndjeshme gjinore dhe të bazuara në të drejtat e njeriut. Koordinimi i përpjekjeve për barazi gjinore me zhvillimin social e bën këtë plan një instrument kryesor për ndërtimin e një shoqërie më të drejtë, ku askush nuk mbetet pas.

Për të shprehur sa më qartë domosdoshmërinë e gjithëpërfshirjes, në të gjithë tekstin në vijim në këtë PVVBGJ, është përdorur në mënyrë të vazhdueshme shprehja ***“në të gjithë diversitetin e tyre”***, që të theksohet rëndësia e mbështetjes, trajtimit dhe fuqizimit të të gjithë individëve, e në mënyrë të veçantë, të grave, të rejave dhe vajzave në tërësi, përfshirë edhe nga grupe të cënueshme e që pësojnë diskriminim të shumëllojshëm si: gra, të reja dhe vajza nga zonat rurale, nga minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, nëna të vetme, të dhunuara, të trafikuar, të moshuara, emigrante, azilkërkuese, etj., pra nga të gjithë grupet në shoqëri. Ky term gjithashtu përdoret gjerësisht në dokumentet e Bashkimit Evropian, sidomos ato që janë pjesë e acquis të BE-së për barazinë gjinore, ku specifikisht adresojmë Strategjinë e BE-së për Barazinë Gjinore 2020 – 2025, si dhe Planin e Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore III 2021 – 2025/2027<sup>9</sup> (EU GAP III).

<sup>9</sup> EU GAP III u përgatit fillimisht për periudhën kohore 2021 – 2025, por në nëntor të vitit 2023, BE vendosi të shtrijsë kohëzgjatjen e tij deri në vitin 2027. Shih: [https://enlargement.ec.europa.eu/news/gender-equality-eu-extends-duration-gender-action-plan-external-action-build-its-achievements-2023-11-21\\_en](https://enlargement.ec.europa.eu/news/gender-equality-eu-extends-duration-gender-action-plan-external-action-build-its-achievements-2023-11-21_en)

Theksi te gratë, të rejat dhe vajzat, nga të gjitha qupet në shoqëri, është vënë edhe në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030, dokumenti kryesor i politikave në nivel kombëtar që përshkruan veprimet që duhet të ndërmerren për përparimin drejt barazisë gjinore.

***Prandaj, kudo në këtë tekst, togfjalëshi “në të gjithë diversitetin e tyre” nënkupton që veprimet dhe masat e ndërmarra synojnë të përfshijnë gra, të reja, vajza në tërësi, përfshirë edhe nga grupe të cënueshme e që pësojnë diskriminim të shumëfishtë e të ndërthurur si: gra, të reja dhe vajza nga zonat rurale, nga minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, nëna të vetme, të dhunuara, të trafikuar, të moshuara, emigrante, azilkërkuese, etj.***

## II. KUADRI LIGJOR DHE INSITUCIONAL

Kur flasim për kuadrin ligjor dhe të politikave në fushën e barazisë gjinore, duhet të kemi parasysh që e drejta për barazi ndërmjet gjinive buron që në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 18), që është edhe dokumenti ligjor më i lartë në hierarkinë ligjore të vendit. Në nenin 18 të Kushtetutës qartësohet shprehimisht se: *“1. Të gjitha/gjithë janë të barabarta/barabartë përpara ligjit; 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore; 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive”*.

Kjo barazi de-jure është gjithashtu e shprehur edhe në një tërësi instrumentesh ndërkombëtarë, të cilët kur ratifikohen nga Parlamenti shqiptar, zënë vend në hierarkinë ligjore të vendit menjëherë pas Kushtetutës, çfarë nënkupton që nëse për një çështje të caktuar nuk ka një parashikim të qartë në legjislacionin vendas, atëherë për zgjidhjen e saj u drejtohem parashikimeve në instrumentet ndërkombëtarë të ratifikuar.

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2025 - 2030 përveçse si një instrument i zbatimit të Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, mbështetet në një tërësi dokumentesh të rëndësishëm ligjorë dhe institucionalë, të cilët udhëheqin njëkohësisht edhe veprimet mbarëkombëtare për fuqizimin e gruas dhe përparimin drejt barazisë gjinore në Shqipëri. Si më kryesoret mund të përmendim:

### a) *Instrumente ndërkombëtarë*

- Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore (EU Charter for Equality).<sup>10</sup>
- Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW).
- Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA).
- Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).
- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) dhe Agjenda 2030.
- Strategjia e Barazisë Gjinore 2020-2025 e Bashkimit Evropian dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore 2021-2025/2027.
- Udhërrëfyti i BE-së për fuqizimin e grave, publikuar në 7 mars 2025<sup>11</sup>, etj.

### b) *Kuadri ligjor kombëtar*<sup>12</sup>

- Ligji Nr.9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri” (në proces rishikimi).
- Ligji Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

<sup>10</sup> E renditur në krye të kësaj liste për shkak të rëndësisë që ka në nivelin vendor në lidhje me vetë përgatitjen e këtij PVVBGJ. Ndonëse ky dokument nuk është i ratifikuar nga shteti shqiptar, sepse nuk ka një procedurë të tillë, pjesëmarrja në të bëhet nëpërmjet nënshkrimit nga ana e vetë bashkive.

<sup>11</sup> Shih: [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2025/769542/EPRS\\_BRI\(2025\)769542\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2025/769542/EPRS_BRI(2025)769542_EN.pdf)

<sup>12</sup> Theksojmë se kjo listë nuk është shteruese. Të gjitha masat dhe veprimet e parashikuara në këtë PVVBGJ, mbështeten jo vetëm në këtë kuadër ligjor për barazinë gjinore, por edhe në ligje të veçanta në përputhje me fushën përkatëse të ndërhyrjes.

- Ligji Nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".
- Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar.
- Ligji Nr.221/04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar.
- Ligji Nr.7895, datë 27.01.1995, "Kodi penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji Nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji Nr.93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara".
- Ligji Nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji Nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji Nr. 65/2016 "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".
- Ligji Nr. 37/2017 "Kodi i drejtësisë penale për të mitur".
- Ligji Nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".
- Ligji Nr. 7905, datë 21.03.1995, "Kodi i procedurës penale", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 79/2017 "Për sportin".
- Ligji Nr. 22/2018 "Për strehimin social", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit".
- Ligji Nr. 75/2019 "Për rininë", i ndryshuar etj.

#### c) **Politikat kombëtare**

Të gjitha masat dhe veprimet e parashikuara në këtë PVVBGJ 2025 - 2030 kuptohet që mbështeten edhe në strategjitë apo planet kombëtare të veprimit që mbulojnë sektorët (drejtoritë) e caktuara sipas fushave të tyre. Por politika kryesore kombëtare mbi të cilën bazohet ky PVVBGJ është **Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 -2030**.<sup>13</sup>

#### d) **Institucionet përgjegjëse**

Siç përshkruhet edhe në Kartën Evropiane për Barazi, përgjegjës kryesorë për zbatimin e kësaj Karte përmes përgatitjes dhe zbatimit të PVVBGJ, janë bashkitë. Në mënyrën se si është ndërtuar dhe funksionon mekanizmi kombëtar për barazinë gjinore në Shqipëri, në nivel të vetëqeverisjes vendore janë Nëpunëset/Nëpunësit e Barazisë Gjinore (NBGJ) përgjegjëse/përgjegjës për zbatimin e veprimeve në këtë drejtim, të cilat/cilët përveçse brenda institucionit të tyre raportojnë, sipas kërkesës, edhe në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. **Megjithatë, ky Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore, nuk është plani i një nëpunëseje/nëpunësi të vetëm, por është një dokument i Bashkisë**, për zbatimin me efektivitet të të cilit mban përgjegjësi i gjithë stafi i bashkisë dhe njësisë administrative, në bashkëpunim dhe me të gjithë institucionet vendore dhe organizatat e shoqërisë civile të angazhuara në këtë drejtim.

<sup>13</sup> Miratuar me VKM nr.400, datë 30.06.2021. Shiko: <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/07/Strategjia-Kombetare-per-Barazine-Gjinore-2021-2030.docx>

Rol të rëndësishëm në lidhje me adresimin e çështjeve gjinore, në nivelin vendor luajnë edhe **Aleanca e Grave Këshilltare** dhe **Komisioni i Arsimit, Sporteve, Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore dhe të Drejtave të Njeriut**<sup>14</sup> në nivel të Këshillit Bashkiak.

Për të pasur efektivitet në zbatimin e PVVBGJ dhe monitorimin e vazhdueshëm të këtij zbatimi, Bashkia Kamëz ka planifikuar si pjesë të veprimeve të këtij PVVBGJ edhe ngritjen e një Komisioni për Barazi Gjinore / Grupi Monitorimi në nivel bashkie, i përbërë nga përfaqësuese e përfaqësues të Drejtorive përgjegjëse për zbatimin e këtij PVVBGJ, duke përfshirë jo vetëm ato/ata të cilat/cilët ishin edhe pjesë e grupit të punës që përgatiti këtë plan, por edhe të drejtorive të tjera sipas nevojës.

Ky Komision/Grup, do të mundësojë një zbatim akoma më të mirë të PVVBGJ-së edhe për ata elementë që nuk janë të përmendur në mënyrë të detajuar në matricë, por që siç u theksua edhe më sipër, janë të domosdoshëm për përparimin në drejtim të fuqizimit të grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre dhe arritjen e barazisë gjinore (p.sh. ky Komision/Grup do të mundësojë përfshirjen e perspektivës gjinore në të gjithë dokumentet zhvillimore të bashkisë, pavarësisht sektorit apo çështjes që mbulojnë). Ndaj dhe formalizimi i këtij Komisioni për Barazinë Gjinore/ Grupi Monitorues për PVVBGJ në nivel bashkie është një ndër hapat e parë të parashikuar për zbatim, menjëherë pas miratimit të PVVBGJ në Këshillin Bashkiak.

Në vijim, të gjithë institucionet vendore dhe organizatat e shoqërisë civile të cilat përfshihen si partnere për zbatimin e masave dhe veprimeve kryesore në këtë PVVBGJ, janë të rëndësishme dhe të domosdoshme për të pasur rezultatet e dëshiruara në përparimin drejt barazisë gjinore. Rol të rëndësishëm këtu luajnë edhe organizatat ndërkombëtare nëpërmjet mbështetjes financiare dhe teknike për të zbatuar masa të caktuara të parashikuara në këtë PVVBGJ.

---

<sup>14</sup> Shih: <https://kamza.gov.al/wp-content/uploads/2025/02/komisionet-Kamza.pdf>

### III. METODOLOGJIA

Metodologjia për hartimin e PVVBGJ 2025 - 2030 ishte gjithëpërfshirëse dhe u zhvillua përmes hapave në vijim:

- **Ngritja e Grupit të Punës.** Grupi i Punës për hartimin e këtij PVVBGJ u ngrit me Urdhër të Kryetarit, nr.483, datë 10.07.2025 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore”, ndryshuar me Urdhërin Nr.632 datë 20.07.2025 “Për një ndryshim në Urdhërin Nr. 483 datë 10.0.2025 ‘Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore’”. Në përbërje të këtij grupi ishin 15 anëtare/anëtarë, nga të cilat/cilët 14 gra dhe 1 burrë.
- **Analiza dhe vlerësimi i situatës përmes të dhënave dhe informacionit ekzistues (desk review).** Kjo analizë u bazua në një tërësi dokumentesh ekzistues apo draft dokumentesh të bashkisë, por padyshim që u shtri edhe në tërësinë e kuadrit ligjor dhe të politikave ekzistuese kombëtare e vendore, të lidhura me çështjet gjinore.
- **Përcaktimi i fushave kryesore të ndërhyrjes, të domosdoshme për t’u përfshirë në matricën e PVVBGJ 2025-2030.** Ky përcaktim u bë duke ndjekur një tërësi hapash, që filluan nga identifikimi i prioriteteve bazuar në desk review, e deri tek marrja në konsideratë dhe reflektimi i duhur i komenteve dhe sugjerimeve të ardhura nga diskutimet me stafin e bashkisë, NJA-të, si dhe nga partnerët dhe bashkëpunëtorët kryesorë të bashkisë.
- **Konsultimet paraprake brenda bashkisë.** Këto konsultime u zhvilluan me stafin e bashkisë (përfaqësuese dhe përfaqësues nga të gjitha drejtoritë në bashki), si dhe administratoret/administratorët e NJA-ve. Ky hap u konsiderua i domosdoshëm, së pari për të mundësuar njohjen me Kartën Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore për të gjitha/gjithë ata persona që nuk e kishin këtë informacion më herët, por edhe për të diskutuar mbi detaje që lidhen me formatin dhe përmbajtjen në tërësi të PVVBGJ. Janë zhvilluar gjithsej **katër takime të Grupit të Punës**, përkatësisht në datat 15 korrik 2025, 23 korrik 2025, 30 korrik 2025 dhe 1 gusht 2025.
- **Konsultim me një grup të ngushtë partnerësh e bashkëpunëtorësh.** Grupi i Punës mendoi që në takimin e tretë të tij (përkatësisht në datën 30 korrik 2025) të ftonte edhe një rreth të ngushtë partnerësh e bashkëpunëtorësh, për të diskutuar parimisht mbi përmbajtjen e PVVBGJ. Ky takim rezultoi i suksesshëm, me diskutime e propozime konkrete nga të ftuarat/ftuarit.
- **Përgatitja e draft dokumentit të PVVBGJ 2025 - 2030.** Drafti matrica e përgatitur për konsultim përmbante masat dhe veprimet e parashikuara të përfshira në katër fusha ndërhyrjeje, të bazuara edhe në fushat prioritare të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030 (pra fuqizimi ekonomik, pjesëmarrja në vendimmarrjen politike e publike, dhuna me bazë gjinore dhe integrimi gjinor në nivelin vendor. Grupi i Punës në konsultim edhe me partnerët propozuan edhe një fushë të pestë ndërhyrjeje të fokusuar te çështje të aksesit në ujë të pijshëm dhe barazisë gjinore, por meqenëse në terma të zbatimit do kishte shumë vështirësi (për shkak të mënyrës së funksionimit të Ujësjellës Kanalizime si SH.A.), në takimin e katërt të Grupit të Punës u vendos që ky objektivi dhe

fusha përkatëse e ndërhyrjes të hiqen. Në këtë draft u reflektuan vazhdimisht të gjitha ndryshimet e dakortësuara në konsultimet paraprake brenda bashkisë.

- **Konsultime me palët e interesuara dhe grupet e interesit.** Ky proces u zhvillua mbi draft dokumentin e përgatitur. Në konsultime u përfshinë drejtoritë përgjegjëse dhe stafi brenda bashkisë, NJA-ve, si dhe anëtare të Aleancës së Grave Këshilltare dhe të Këshillit Bashkiak. Në datën 5 gusht 2025 draft PVVBGJ u postua në faqen e internetit të bashkisë për konsultim publik dhe një takim konsultues me publikun u mbajt në datën 11 gusht 2025.<sup>15,16</sup>
- **Kostimi i draft PVVBGJ 2025-2030.** Pas finalizimit të matricës së aktiviteteve dhe qartësimit të tyre me çdo drejtori, paralelisht filloi dhe kostimi i aktiviteteve të dakortësuara.
- **Miratimi i PVVBGJ 2025 – 2030 në Këshillin Bashkiak.** Versioni përfundimtar i PVVBGJ i konsultuar e kostuar u përcoll për miratim në Këshillin Bashkiak. Pas miratimit, PVVBGJ 2025 – 2030 do të publikohet edhe në faqen e internetit të bashkisë, si dhe versioni anglisht i tij do të publikohet në faqen e Atlasit të Nënshkruesve të Kartës Evropiane për Barazi, të Këshillit të Bashkive dhe Rajoneve të Evropës (KBRE).

**Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2025 - 2030 i Bashkisë Kamëz, u miratua në mbledhjen e Këshillit Bashkiak në gusht 2025.<sup>17</sup>**

Të gjitha hapat e mësipërm shkojnë në linjë dhe me metodologjinë e përgatitjes së PVVBGJ-ve siç sugjerohet nga KBRE.<sup>18</sup>

Një rol të rëndësishëm në të gjithë procesin e përgatitjes deri në finalizimin e PVVBGJ ka luajtur mbështetja dhe asistenca teknike e ofruar nga UN Women, përmes dy konsulentëve<sup>19</sup> të angazhuara për këtë qëllim, në kuadër të zbatimit të projektit: Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore II - Instrumenti i Lehtësimit të Barazisë Gjinore në Shqipëri" (EU4GE II), që financohet nga Bashkimi Evropian.

<sup>15</sup> Shih: <https://kamza.gov.al/wp-content/uploads/2025/08/Njoftim-per-Konsultim-Publik-mbi-Hartimin-e-Planit-Vendor-per-Barazine-Gjinore.pdf>

<sup>16</sup> Shih: <https://kamza.gov.al/wp-content/uploads/2025/08/Procesverbal-mbi-konsultimin-publik-per-hartimin-e-Planit-Vendor-te-Veprimit-Per-Barazine-Gjinore.pdf>

<sup>17</sup> Shih: <https://kamza.gov.al/category/vendimet/>

<sup>18</sup> Për më shumë shih: <https://charter-equality.eu/the-action-plan-step-by-step/definir-un-plan-daction-en.html>

<sup>19</sup> Znj. Monika Kocaqi, eksperte e nivelit të lartë për integrimin gjinor dhe vetëqeverisjen vendore, si dhe znj. Diamanta Vito, eksperte e nivelit të lartë për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor dhe vetëqeverisjen vendore. Për përgatitjen e treguesve gjinorë të këtij PVVBGJ u angazhua edhe znj. Majlinda Nesturi, eksperte e nivelit të lartë për statistikat dhe treguesit gjinorë.

#### IV. VIZIONI, FUSHAT E NDËRHYRJES DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË

**Vizioni:** *“Gratë dhe burrat, të rejat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë e Kamzës, pavarësisht moshës, vendbanimit, grupit etnik e social, aftësive të kufizuara e nevojave të veçanta, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, statusit civil, të emigrantes/emigrantit e azilkërkueses/azilkërkuesit, statusit të punësimit e gjendjes ekonomike, përkatësisë fetare, apo karakteristikave të tjera individuale, gëzojnë, respektojnë dhe kontribuojnë për përparimin drejt barazisë gjinore dhe zbatimin e saj në praktikë, në të gjitha fushat e jetës”.*

**Parimet**<sup>20</sup> që udhëheqin zbatimin e PVVBGJ, janë të njëjtat parime që udhëheqin në tërësi zbatimin e Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, siç paraqiten në vijim:

1. Barazia ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, përbën një të drejtë themelore.
2. Për të siguruar barazinë gjinore duhet të trajtohen çështjet e diskriminimit dhe të pengesave të shumëfishta.
3. Pjesëmarrja e balancuar e grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, në vendimmarrje, është parakusht për një shoqëri demokratike.
4. Eliminimi i stereotipeve gjinore ka rëndësi themelore për arritjen e barazisë gjinore.
5. Integrimi i këndvështrimit gjinor në të gjitha veprimtaritë e organeve të vetëqeverisjes vendore është i nevojshëm për të çuar përpara barazinë gjinore.
6. Planet e veprimit, të mbështetura me burimet e duhura, janë instrumente të nevojshme për çuarjen përpara të barazisë gjinore.

#### Fushat kryesore të ndërhyrjes

PVVBGJ 2025 - 2030 përbëhet nga katër fusha kryesore të ndërhyrjes, të cilat jo vetëm kanë në përmbajtje nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi, por janë harmonizuar edhe me një pjesë të objektivave specifike të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030, sidomos ato që përmbajnë masa dhe veprime ku përgjegjës kryesorë për zbatim janë Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV). Këto fusha ndërhyrjeje janë:

- I. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre.
- II. Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave dhe të rejave e të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike apo publike në nivelin vendor.
- III. Liri nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje.
- IV. Integrimi gjinor në politikat vendore.

Secila nga këto fusha të ndërhyrjes është zbrëthyer më tej në rezultatet e pritshme, objektivat specifike, treguesit e matjes së tyre, si dhe në masa e veprime konkrete, të cilat detajohen në matricën e planit të veprimit, ku jepet një informacion më i plotë si për zbatimin dhe vlerësimin e rezultateve, ashtu edhe për sa u përket neneve specifike të Kartës Evropiane, si dhe dokumenteve të tjerë kryesorë ku mund të referohemi, në përmbushje të veprimeve të parashikuara nën secilën fushë ndërhyrjeje.

Përparimi dhe efektiviteti në zbatimin e PVVBGJ kërkon domosdoshmërisht vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme dhe të mjaftueshme njerëzore, financiare e

<sup>20</sup> Për shpjegime më të hollësishme mbi secilin parim, mund të referoheni tek teksti i Kartës Evropiane për Barazi në adresën: [https://www.ccre.org/img/uploads/piecesjointe/filename/charte\\_egalite\\_al.pdf](https://www.ccre.org/img/uploads/piecesjointe/filename/charte_egalite_al.pdf)

infrastrukturore, si dhe koordinimin e veprimeve dhe bashkëpunimin ndërinstitucional me institucionet e tjera vendore, organizatat e shoqërisë civile, bizneset, median, si dhe organizatat ndërkombëtare të cilat punojnë për fuqizimin e grave dhe arritjen e barazisë gjinore.

Mbledhja dhe përditësimi rregullisht i të dhënave të ndara jo vetëm sipas seksit, por edhe sipas një tërësie karakteristikash të tjera individuale, monitorimi i vazhdueshëm mbi ecurinë e zbatimit të veprimeve të parashikuara, si dhe transparenca e llogaridhënia për rezultatet e arritura, janë gjithashtu domosdoshmëri për të përparuar drejt vizionit që udhëheq këtë PVVBGJ.

#### **Rezultatet e pritshme, objektivat specifikë dhe treguesit**

##### **Fusha e ndërhyrjes:**

#### **I. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre.**

##### **Rezultatet e pritshme:**

- I.a. Veprimet e bashkisë për të nxitur rritjen e punësimit dhe fuqizimin ekonomik të grave e të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, të përmirësuara ndjeshëm.
- I.b. Masat që synojnë nxitjen e sipërmarrjes së grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, të përshtatura me nevojat e tyre specifike.

##### **Objektivat specifikë:**

- I.1. Rritja e aksesit të grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, ndaj shërbimeve, produkteve dhe burimeve financiare që ndikojnë në fuqizimin ekonomik dhe përmirësimin e situatës ekonomike të tyre.

##### **Treguesit në nivel objektivi specifik:**

- I.1.a. Numri i grave dhe të rejave përfituese nga aktivitetet e fuqizimit të kapaciteteve (trajnime dhe programe të formimit profesional), ndarë sipas moshës, përkatësisë etnike-kulturore, aftësisë së kufizuar, vendbanimit, llojit të aftësive të përfituara (llojit të trajnimit), etj.
- I.1.b. Numri i sipërmarrjeve të reja, të themeluara ose të drejtuara nga gratë dhe të reja, të cilat kanë marrë mbështetje financiare nga bashkia gjatë periudhës së zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ), e ndarë sipas sektorëve (biznes, bujqësi, turizëm, teknologji, etj.).

##### **Fusha e ndërhyrjes:**

#### **II. Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave dhe të rejave e të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike apo publike në nivelin vendor.**

##### **Rezultatet e pritshme:**

- II.a. Aktivitetet dedikuar pjesëmarrjes dhe përfaqësimit në vendimmarrjen politike apo publike, adresojnë në mënyrën e duhur sfidat dhe stereotipet gjinore ekzistuese.
- II. b. Veprimet që ndërmerr bashkia në këtë drejtim, nxitin zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe parimet e barazisë e gjithëpërfshirjes, veçanërisht për grupet më pak të përfaqësuara.

##### **Objektivat specifikë:**

- II.1. Rritja e pjesëmarrjes në vendimmarrjen politike e publike në nivelin vendor, për gratë dhe të reja, në të gjithë diversitetin e tyre.

##### **Treguesit në nivel objektivi specifik:**

- II.1.a. Numri i të rejave dhe të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, që kanë përfunduar trajnime për zhvillimin e aftësive udhëheqëse dhe për integrimin gjinor në vendimmarrje.
- II.1.b. Përqindja e grave dhe të rejave drejtuese, në të gjithë diversitetin e tyre, në strukturat vendimmarrëse në Bashki, Këshillin Bashkiak, Njësitë Administrative, Këshillat e Fshatrave, etj.

**Fusha e ndërhyrjes:**

**III. Liri nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje.**

**Rezultatet e pritshme:**

- III.a. Mekanizmi i Koordinuar i Referimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, i fuqizuar dhe efikas.
- III.b. Një brez i ri i barazisë, që lufton stereotipet gjinore, praktikën e dëmshme dhe diskriminimin apo disavantazhimin e shumëfishtë, i krijuar dhe fuqizuar.
- III.c. Veprimet e bashkisë për ndërtimin e komuniteteve të sigurta, të paqta e gjithëpërfshirëse, të përmirësuara ndjeshëm.

**Objektivat specifikë:**

- III.1. Fuqizimi dhe rritja e efikasitetit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit kundër dhunës në familje.
- III.2. Zvogëlimi i stereotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë, përmes edukimit të shoqërisë me parimet e barazisë gjinore.
- III.3. Fuqizimi i grave, të rejave dhe të rinjve, për ndërtimin e komuniteteve të sigurta, përmes promovimit të Agjendës "Gruaja, Paqja dhe Siguria" dhe Agjendës "Rinia, Paqja dhe Siguria".

**Treguesit në nivel objektiv specifik:**

- III.1.a. Numri i rasteve të dhunës në familje të denoncuar dhe të trajtuara nga MKR, krahasuar me numrin total të rasteve të dhunës në familje të regjistruara nga Bashkia.
- III.1.b. Përqindja e buxhetit të bashkisë dedikuar shërbimeve mbështetëse të specializuara për rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.
- III.2.a. Numri i aktiviteteve ndërgjegjëse të organizuara nga bashkia për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.
- III.3.a. Përqindja e grave, burrave, të rejave dhe të rinjve të përfshira/përfshirë në aktivitete që synojnë paqen, sigurinë dhe ndërtimin e komuniteteve të sigurta e gjithëpërfshirëse.

**Fusha e ndërhyrjes:**

**IV. Integrimi gjinor në politikat vendore.**

**Rezultatet e pritshme:**

- IV.a. Përgjegjshmëria dhe transparenca e bashkisë mbi përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore, e rritur ndjeshëm.
- IV.b. Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor i zbatuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe integrimi gjinor i reflektuar në politikat dhe planet e bashkisë.

**Objektivat specifikë:**

- IV.1. Rritja e përgjegjshmërisë dhe transparencës së bashkisë në përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore.
- IV.2. Zbatimi i detyrimeve për integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në nivel vendor.

#### Treguesit në nivel objektiv specifik:

- IV.1.a. Numri i raporteve të monitorimit të zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore, të miratuara në Këshillin Bashkiak dhe të publikuara në faqen zyrtare të bashkisë dhe në Atlasin e Nënshkruesve të Kartës Evropiane për Barazi, të Këshillit të Bashkive dhe Rajoneve të Evropës (KBRE).
- IV.2.a. Numri i programeve buxhetore të analizuar nën këndvështrimin gjinor.
- IV.2.b. Përqindja e buxhetit vjetor të bashkisë e dedikuar për zbatimin e PVVBGJ, dhe norma vjetore e rritjes së tij, krahasuar me përqindjen e buxhetit të shpenzuar për këtë qëllim.

#### V. KOSTO PËR ZBATIMIN E PVVBGJ 2025 - 2030

Të gjitha aktivitetet e parashikuara në matricën e PVVBGJ 2025 - 2030 shoqërohen edhe me një kosto financiare të domosdoshme për zbatimin e tyre, e cila zbërthehet më tej në kosto që mbulohet nga vetë Bashkia, kosto që mbulohet nga donatorët dhe palët e treta, si dhe kosto që ka nevojë për t'u siguruar (apo hendeuku financiar).

Është e rëndësishme të theksohet se një pjesë të mirë të aktiviteteve Bashkia e mbulon përmes angazhimit të burimeve ekzistuese njerëzore e financiare (pra specialisteve / specialistëve, të cilat / cilët aktualisht marrin një page fikse, sallave / ambienteve që ka në pronësi për të zhvilluar aktivitete të ndryshme, apo vënien në dispozicion të makinës dhe materialeve kancelarike të cilat blihen në total për të gjithë institucionin), etj. – ***pra që nuk ka nevojë për kosto shtesë pasi këto kosto parashikohen në mënyrë të përvitshme.*** Megjithatë, në këtë Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore 2025 - 2030 evidentohet edhe vlera përkatëse e këtij kontributi, me qëllim që gjatë monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të tij, të mundësohet vlerësimi edhe përmes kosto-eficencës.

Gjithashtu, është e rëndësishme të mbahet në konsideratë fakti që këto përlllogaritje janë bërë për minimumin e vlerave që do të kërkonte organizimi i aktiviteteve të propozuara.

Në seksionin VI “Matrica e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025 - 2030”, për çdo masë/aktivitet të parashikuar, në kolonën e kostos jepet informacion për:

- a. **Vlerën totale të kostos të zhvillimit të masës/aktivitetit.** Kjo kosto është përlllogaritur si kosto bazë (pra me zërat që përmban zbatimi i aktivitetit), e shumëzuar me numrin e aktiviteteve të parashikuara për zbatim për të gjithë kohëzgjatjen e zbatimit të PVVBGJ.
- b. **Vlerën e kostos që mbulohet nga Bashkia.** Këtu duhet pasur parasysh se kjo vlerë jo domosdoshmërisht është shtesë në buxhetin e bashkisë, ajo mund të jetë edhe në formën e angazhimit të pjesshëm të specialisteve/specialistëve të drejtorive përkatëse (pra disa ditë pune ia kushtojnë zbatimit të masës/aktivitetit, brenda pagës mujore që kanë), ose në formën e kontributit “në natyrë (in kind)” përmes vënies në dispozicion të sallave e ambienteve, etj. Po kështu, në ato raste kur masa apo veprimi është i parashikuar si detyrim parësor në një tjetër plan veprimi, në lidhje me kostot, është cituar referenca në planin përkatës, për të shmangur kështu mbivendosjet në përlllogaritjet financiare.
- c. **Vlerën e kostos që mbulohet nga donatorët.** Kjo nënkupton që për zhvillimin e masës/aktivitetit ka një dakortësi paraprake me donatorët mbi kontributin e tyre. Në



këtë rast, janë përlogaritur si të mbuluara, vetëm kostot për ato aktivitete që ka pasur një dakortësi / marrëveshje mes bashkisë dhe donatorit, në momentin e përgatitjes së këtij PVVBGJ. Paralelisht, bashkia do vijoje punën për identifikimin e donatorëve të ndryshëm dhe shtimin e mbështetjes nga ana e tyre, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së zbatimit të këtij PVVBGJ.

- d. **Hendeku financiar.** Ky ka të bëjë me vlerën e kostos të pa mbuluar nga asnjë burim në momentin e miratimit të këtij plani. Kjo vlerë mund të mbulohet përmes negocimit me donatorët, bizneset, OJF të specializuara, etj., ose mund edhe të parashikohet brenda Planeve Buxhetore Afatmesme (PBA) e buxheteve vjetore, duke filluar nga PBA 2026 - 2028.

Kostot e paraqitura janë orientuese dhe miratimi i këtij Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025 - 2030, të kostuar, nuk nënkupton automatikisht edhe buxhetimin e tij. Për të buxhetuar dhe alokuar fondet përkatëse të përvitshme, pa të cilat zbatimi i këtij PVVBGJ nuk merr jetë, Bashkia duhet të përfshijë në parashikimet buxhetore vjetore dhe afatmesme edhe masat e parashikuara në të. Në këtë kuadër edhe mbështetja dhe lobimi nga vetë gratë këshilltare për sigurimin e burimeve financiare për realizimin e aktiviteteve / masave, përmes përfshirjes së tyre në buxhete vjetore apo afatmesme të Bashkisë, është domosdoshmëri.

Me rishikimin e përvitshëm të Planit Vendor të Veprimit, ***duhet bërë patjetër edhe rishikimi i kostove të propozuara***, bazuar edhe në mënyrën e përfshirjes së tyre në buxhetet vjetore apo PBA-të e Bashkisë, si dhe në marrëveshjet me donatorët apo partnerët e mundshëm. Kjo kërkon një vëmendje të shtuar sidomos në periudhën e përgatitjes së PBA-ve dhe buxheteve vjetore, për të përfshirë në to masat dhe veprimet e parashikuara në matricën e PVVBGJ, sipas ndarjeve në vite.

Nga përlogaritjet e bëra rezulton se kostot në tërësi për zbatimin e PVVBGJ 2025 - 2030 janë në vlerën **60,877,345 lekë**. Nga këto:

- **47,991,111 lekë** janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes I “Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre”.
- **1,851,117 lekë** janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes II “Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave dhe të rejave e të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike apo publike në nivelin vendor”.
- **9,837,515 lekë** janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes III “Liri nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje”.
- **1,197,602 lekë** janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes IV “Integrimi gjinor në politikat vendore”.

Në totalin e kostos **60,877,345 lekë** të nevojshme për zbatimin në tërësi të PVVBGJ 2025-2030 për të gjithë kohëzgjatjen e tij:

- **38,606,422 lekë janë kosto që do të mbulohen nga Bashkia** (me stafin ekzistues dhe me kontribut në natyrë – salla, mjete, etj.), pra ***të cilat nuk kanë nevojë të përlogariten si shtesë në buxhet, sepse edhe burimet njerëzore edhe infrastrukture ekzistojnë.***
- **2,530,548 lekë janë kosto që mbulohen nga donatorë** të ndryshëm (të cilët kanë dakordësuar paraprakisht gjatë përgatitjes së draft PVVBGJ-së).

- **19,740,375 lekë janë hendek financiar,** për të cilat bashkia do të llojë për gjetjen e burimeve financuese, ose do të bëjë planifikimet e saj shtesë në PBA-të e ardhshme, duke filluar nga PBA 2026 – 2028.

| Objektivat strategjikë                                                                                                                                                           | Objektivat specifikë                                                                                                                                                                                                 | Gjithsej kosto<br>2025 - 2030 | Bashkia<br>(Lekë)      | Donatorë të<br>konfirmuar<br>(Lekë) | Hendek<br>financiar<br>(Lekë) |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|------------------------|-------------------------------------|-------------------------------|
| <b>I. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre.</b>                | I.1. Rritja e aksesit të grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, ndaj shërbimeve, produkteve dhe burimeve financiare që ndikojnë në fuqizimin ekonomik dhe përmirësimin e situatës ekonomike të tyre. | 47,991,111 lekë               | 31,164,799 lekë        | 2,156,000 lekë                      | 14,670,312 lekë               |
| <b>Gjithsej Objektiv i strategjik I:</b>                                                                                                                                         |                                                                                                                                                                                                                      | <b>47,991,111 lekë</b>        | <b>31,164,799 lekë</b> | <b>2,156,000 lekë</b>               | <b>14,670,312 lekë</b>        |
| <b>II. Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave dhe të rejave e të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike apo publike në nivelin vendor.</b> | II.1. Rritja e pjesëmarrjes në vendimmarrjen politike e publike në nivelin vendor, për gratë dhe të reja, në të gjithë diversitetin e tyre.                                                                          | 1,851,117 lekë                | 1,366,862 lekë         | 71,840 lekë                         | 412,415 lekë                  |
| <b>Gjithsej Objektiv i strategjik II:</b>                                                                                                                                        |                                                                                                                                                                                                                      | <b>1,851,117 lekë</b>         | <b>1,366,862 lekë</b>  | <b>71,840 lekë</b>                  | <b>412,415 lekë</b>           |
| <b>III. Liri nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe</b>                                                                                                        | III.1. Fuqizimi dhe rritja e efikasitetit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit kundër                                                                                                                            | 5,698,122 lekë                | 2,877,874 lekë         | 0 lekë                              | 2,820,248 lekë                |

|                                           |                                                                                                                                                                                              |                       |                       |                     |                       |
|-------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------|-----------------------|---------------------|-----------------------|
| dhunës në familje.                        | dhunës në familje.                                                                                                                                                                           |                       |                       |                     |                       |
|                                           | III.2. Zvogëlimi i stereotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë, përmes edukimit të shoqërisë me parimet e barazisë gjinore.                | 3,825,239 lekë        | 2,754,635 lekë        | 140,500 lekë        | 930,104 lekë          |
|                                           | III.3. Fuqizimi i grave, të rejave dhe të rinjve për ndërtimin e komuniteteve të sigurta, përmes promovimit të Agjendës "Gruaja, Paqja dhe Siguria" dhe Agjendës "Rinia, Paqja dhe Siguria". | 314,154 lekë          | 130,654 lekë          | 0 lekë              | 183,500 lekë          |
| <b>Gjithsej Objektivi strategjik III:</b> |                                                                                                                                                                                              | <b>9,837,515 lekë</b> | <b>5,763,163 lekë</b> | <b>140,500 lekë</b> | <b>3,933,852 lekë</b> |
| 4. Integrimi gjinor në politikat vendore. | IV.1. Rritja e përgjegjshmërisë dhe transparencës së bashkisë në përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore.                                                                     | 825,100 lekë          | 62,346 lekë           | 50,208 lekë         | 712,546 lekë          |
|                                           | IV.2. Zbatimi i detyrimeve për integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në nivel vendor.                                                                                       | 372,502 lekë          | 249,252 lekë          | 112,000 lekë        | 11,250 lekë           |

|                                          |                          |                        |                        |                        |
|------------------------------------------|--------------------------|------------------------|------------------------|------------------------|
| <b>Gjithsej Objektivi strategjik IV:</b> | <b>1,197,602</b><br>lekë | <b>311,598</b><br>lekë | <b>162,208</b><br>lekë | <b>723,796</b><br>lekë |
|------------------------------------------|--------------------------|------------------------|------------------------|------------------------|

#### VI. RAPORTIMI DHE MONITORIMI

**Procesi i raportimit** për aktivitetet e zbatuara do të kryhet nga Drejtoria ose Sektori përgjegjës për zbatimin e aktivitetit tek **Komisioni për Barazinë Gjinore / Grupi i Monitorimit për zbatimin e PVVBGJ, që do të ngrihet menjëherë pas miratimit të këtij PVVBGJ në nivel të Bashkisë, me përfaqësuese dhe përfaqësues nga secila Drejtori në Bashki.**

Menjëherë pas miratimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025 - 2030, si hap i parë i zbatimit të tij, do të hartohen gjithashtu edhe fletët e treguesve me informacionin që duhet të mbledhet dhe raportohet në bazë aktiviteti, por edhe në bazë të objektivave specifike.

**Raportimet mbi aktivitetet do të jenë periodike (çdo 3 muaj)** ose në bazë të kërkesës së Komisionit për Barazinë Gjinore / Grupit të Monitorimit në nivel bashkie, apo Kabinetit të Kryetares/Kryetarit.

**Raportimet në bazë të objektivave specifike** do të përgatiten **dy herë në vit (çdo 6 muaj).**

**Monitorimi** i zbatimit të Planit Vendor të Veprimit **në nivel të objektivave** do të kryhet nga **Komisioni i Arsimit, Sporteve, Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore dhe të Drejtave të Njeriut, si dhe anëtarët/anëtarët e Këshillit Bashkiak. Bashkia ka përgjegjësinë të përgatisë dhe paraqesë për miratim në Këshillin Bashkiak një raport monitorimi çdo vit.**

Raportet e përgatitura do të përcillen edhe tek Aleanca e Grave Këshilltare dhe sipas nevojës/kërkesës edhe në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), te Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor apo edhe në Agjencinë e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore.

Bazuar në monitorimin e kryer, PVVBGJ **duhet të rishikohet dhe përmirësohet** në mënyrë periodike, sipas nevojës, qoftë edhe çdo një vit nga data e fillimit të zbatimit të tij.

VII. MATRICA E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2025 – 2030

| I. PROMOVIMI I TË DREJTAVE EKONOMIKE, SOCIALE DHE TË PUNËSIMIT TË DENJË, SI DHE FUQIZIMI I VAJZAVE, TË REJAVE DHE GRAVE, NË TË GJITHË DIVERSITETIN E TYRE.                                                                                                                                                      |  |                                                                                                                                                                                                                      |            |                                  |  |                                                                                                                                                                                                                                       |  |              |      |      |      |      |      |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|----------------------------------|--|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--------------|------|------|------|------|------|
| Fusha e ndërhyrjes<br>(Objekti i strategjik):                                                                                                                                                                                                                                                                   |  | Rezultatet e pritshme:                                                                                                                                                                                               |            |                                  |  |                                                                                                                                                                                                                                       |  |              |      |      |      |      |      |
| Rezultatet e pritshme:                                                                                                                                                                                                                                                                                          |  | I.a. Veprimet e bashkisë për të nxitur rritjen e punësimit dhe fuqizimin ekonomik të grave e të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre të përmirësuar ndjeshëm.                                                    |            |                                  |  |                                                                                                                                                                                                                                       |  |              |      |      |      |      |      |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |  | I.b. Masat që synojnë nxitjen e sipërmarrjes së grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, të përshatura me nevojat e tyre specifike.                                                                    |            |                                  |  |                                                                                                                                                                                                                                       |  |              |      |      |      |      |      |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |  | - Karta Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore - nenet 11, 17, 27.                                                                                                                               |            |                                  |  |                                                                                                                                                                                                                                       |  |              |      |      |      |      |      |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |  | - Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) – nenet 11, 12, 13.                                                                                                                |            |                                  |  |                                                                                                                                                                                                                                       |  |              |      |      |      |      |      |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |  | - Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA) – fusha kritike 6.                                                                                                                                            |            |                                  |  |                                                                                                                                                                                                                                       |  |              |      |      |      |      |      |
| Dokumentet kryesore që u referohemi:                                                                                                                                                                                                                                                                            |  | - Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) – neni 12/6.                                                                                         |            |                                  |  |                                                                                                                                                                                                                                       |  |              |      |      |      |      |      |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |  | - Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i BE (EU GAP III) – shtylla III, fushat kryesore tematike 3.3, 3.6.                                                                                                          |            |                                  |  |                                                                                                                                                                                                                                       |  |              |      |      |      |      |      |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |  | - Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2021 – 2030 – objektivat specifikë I.1, I.2, I.3.                                                                                                                |            |                                  |  |                                                                                                                                                                                                                                       |  |              |      |      |      |      |      |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |  | I.1. Rritja e aksesit të grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, ndaj shërbimeve, produkteve dhe burimeve financiare që ndikojnë në fuqizimin ekonomik dhe përmirësimin e situatës ekonomike të tyre. |            |                                  |  |                                                                                                                                                                                                                                       |  |              |      |      |      |      |      |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |  | Treguesit:                                                                                                                                                                                                           |            |                                  |  |                                                                                                                                                                                                                                       |  |              |      |      |      |      |      |
| Objektivi specifik:                                                                                                                                                                                                                                                                                             |  | Baseline:<br>(2025)                                                                                                                                                                                                  |            | Target:<br>(2030)                |  | MONITORIMI                                                                                                                                                                                                                            |  |              |      |      |      |      |      |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |  | Do përcaktohet                                                                                                                                                                                                       |            | Rritur me 2.5%<br>(0.5% çdo vit) |  | Komisioni për Barazi Gjinore në nivel bashkie / Grupi i Monitorimit të PVVBGJ; Komisioni i Arsimit, Sporteve, Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore dhe të Drejtave të Njeriut, si dhe anëtarët/anëtarët e Këshillit Bashkiak. |  |              |      |      |      |      |      |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |  | Do përcaktohet                                                                                                                                                                                                       |            | Rritur me 2.5%<br>(0.5% çdo vit) |  |                                                                                                                                                                                                                                       |  |              |      |      |      |      |      |
| I.1.b. Numri i sipërmarrjeve të reja, të themeluara ose të drejtuara nga gratë dhe të reja, të cilat kanë marrë mbështetje financiare nga bashkia gjatë periudhës së zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ), e ndarë sipas sektorëve (biznes, bujqësi, turizëm, teknologji, etj.). |  |                                                                                                                                                                                                                      |            |                                  |  |                                                                                                                                                                                                                                       |  |              |      |      |      |      |      |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |  |                                                                                                                                                                                                                      |            |                                  |  |                                                                                                                                                                                                                                       |  |              |      |      |      |      |      |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |  |                                                                                                                                                                                                                      |            |                                  |  |                                                                                                                                                                                                                                       |  |              |      |      |      |      |      |
| MASAT DHE AKTIVITETET                                                                                                                                                                                                                                                                                           |  | ZBATIMI                                                                                                                                                                                                              |            | AFATI KOHOR                      |  | TREGUES                                                                                                                                                                                                                               |  | KOSTO (LEKË) |      |      |      |      |      |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |  | Përgjegjës kryesor                                                                                                                                                                                                   | Mbështetës |                                  |  |                                                                                                                                                                                                                                       |  | 2025         | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | 2030 |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |  |                                                                                                                                                                                                                      |            |                                  |  |                                                                                                                                                                                                                                       |  |              |      |      |      |      |      |

|                                                                                                                                                                                                                                                                             |                                                    |                                                                        |                   |                                                                                                                                                           |                                    |                                   |                                   |                                   |                                   |                                   |                                   |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------|-------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------|-----------------------------------|-----------------------------------|-----------------------------------|-----------------------------------|-----------------------------------|-----------------------------------|
| I.1.1.1. Vazhdimi i ofrimit të lehtësirave fiskale (tarifa vendore të hequra për një periudhë të caktuar ose të reduktuara) për aktivitete ekonomike (sipërmarrje e vetëpunësimit) të grave, të rejave e të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre në Kamëz               | Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore           | Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit                                | 2025<br>-<br>2030 | Numri i personave që përfitojnë nga lehtësirat fiskale në sipërmarrje në vit, ndarë sipas seksit, moshës, vendbanimit, llojit të sipërmarrjes, etj.       | 162,000 lekë<br>(hendet financiar) | 162,000 lekë<br>(bashkia)         | 162,000 lekë<br>(bashkia)         | 162,000 lekë<br>(bashkia)         | 162,000 lekë<br>(bashkia)         | 162,000 lekë<br>(bashkia)         | 162,000 lekë<br>(bashkia)         |
| I.1.1.2. Afishimi në ambientet e bashkisë dhe të NJA-ve, si dhe në faqen e internetit të bashkisë, i kërkesave për vende pune të nxjerra nga AKPA, si dhe referimi i grave, burrave, të rejave, të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, për të marrë shërbimet në AKPA | Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale | AKPA<br>NJA<br>Drejtoria e Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun | 2025<br>-<br>2030 | Listat e afishuara apo të publikuara çdo vit<br><br>Numri i personave të referuar në Zyrat e Punës, ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, vendbanimit, etj. | 25,104 lekë<br>(bashkia)           | 25,104 lekë<br>(bashkia)          | 25,104 lekë<br>(bashkia)          | 25,104 lekë<br>(bashkia)          | 25,104 lekë<br>(bashkia)          | 25,104 lekë<br>(bashkia)          | 25,104 lekë<br>(bashkia)          |
| I.1.1.3. Informimi i grave, veçanërisht të zonave rurale, mbi shërbimet e punësimit dhe lehtësirat që ofron bashkia në lidhje                                                                                                                                               | Njësitë Administrative                             | AKPA<br>Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe                               | 2025<br>-<br>2030 | 3 takime të zhvilluara në vit për dhënien e informacionit                                                                                                 | 21,552 lekë<br>(hendet financiar)  | 21,552 lekë<br>(hendet financiar) | 21,552 lekë<br>(hendet financiar) | 21,552 lekë<br>(hendet financiar) | 21,552 lekë<br>(hendet financiar) | 21,552 lekë<br>(hendet financiar) | 21,552 lekë<br>(hendet financiar) |

|                                                                                                                                                                   |                                                |                                                                      |             |                                                                                                                              |     |                                |                                |                                |                                |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------|-------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|--------------------------------|--------------------------------|--------------------------------|--------------------------------|
| me vetëpunësimin dhe fuqizimin ekonomik                                                                                                                           |                                                | Çështjeve Sociale                                                    |             | 15 gra të zonave rurale të informuara në çdo takim, ndarë sipas moshës, vendbanimit, etj.                                    | N/a | 90,000 lekë (hendet financiar) | 90,000 lekë (hendet financiar) | 90,000 lekë (hendet financiar) | 90,000 lekë (hendet financiar) |
| I.1.4. Mbështetja e grave, të rejave dhe të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre për të filluar një start up                                                  | Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik | Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit                              | 2026 - 2030 | Numri i personave të mbështetur me start-up, ndarë sipas seksit, moshës, vendbanimit, llojit të start-up .                   | N/a | 90,000 lekë (hendet financiar) | 90,000 lekë (hendet financiar) | 90,000 lekë (hendet financiar) | 90,000 lekë (hendet financiar) |
| I.1.5. Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me bizneset e zonës për të rritur numrin e grave, të rejave dhe të rinjve që aftësohen profesionalisht e punësohen | Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik | Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale Bizneset e zonës | 2026 - 2030 | 2 marrëveshje të nënshkruara 20 persona të aftësuar profesionalisht apo punësuar në vit, ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, | N/a | 25,104 lekë (bashkia)          | 25,104 lekë (bashkia)          | 25,104 lekë (bashkia)          | 25,104 lekë (bashkia)          |

|                                                                                                                                                                                                                                        |                                                               |                                                                                                                                     |             |                                                                                                                                         |     |     |     |                                                                                                              |                                                                                                              |                                                                                                              |
